

## PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “ Rriveshje rruge me asfalt dhe kalldrëm ”**

#### **PËRCAKTIMI DHE ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :**

Specifikimet/Relacioni Teknik/preventive,grafikudhe projekti per proceduren respektive jane hartuar nga specialiste te fushës nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit. *Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë kontrolluar dhe jane gjetur në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.*Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve/Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike,argumentimi i numrit te punonjesve dhe numrit te mjeteve dhe makinerivepër këtë objekt prokurimi është bërë nga specialisti i fushës, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45233120-6  
VLERA E FONDIT LIMIT:**

**3.332.967** (tre milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë)lekë pa tvsh Fondi Limit i perlloritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr 629 date 15.07.2015 ”Per Miratimin e Manualeve Teknike te Cmimeve te Ndertimit dhe analizat teknike te tyre” i ndryshuar , në zbatim të urdhërit të brendshëm të titullarit të AK “Mbi Përgatitjen e kriterëve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve, bazuar ne dokumentat sipas buxhetit te bashkise te vitit 2023 të miratuara nga Këshilli Bashkiak si dhe dokumentave lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Maliq**\_ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Per kapacitetin ligjor /profesional te operatoreve ekonomike:**

Sipas kriterëve të përgjithshme të Pranim / Kualifikimit.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2019,2020,2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar edhe bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore.

**2.2.2** Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet,2019, 2020,2021 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

**Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c)

Kriteret e kërkuara në pikën 2.2.1 dhe 2.2.2. janë vendosur me qëllim që të vërtëtohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet e nevojshme financiare për përmbushjen e kontratës.

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njërive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetet për vitin 2022 sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.

sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohej sqarime nga autoriteti kontraktor.**

\* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per proceduratatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për

të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:**

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së kontratës që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

#### **Ose**

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit të jetë jo më e vogël se fondi limit i kontratës që prokurohet.

### **Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

*\*Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Për të vërtetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e një kontrate të ngjashme në sektorin publik, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- Formular vlerësimi
- Situacion përfundimtar të objektit,

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Situacionin përfundimtar të objektit;
- Fatura tatimore
- Vërtetim për kryerjen me sukses të kontratës

*(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt

të vetëm, ose sa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

**2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:  
Operatori ekonomik duhet të dorëzojë:**

a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

1. NP 2- A (Ndërtime civile dhe industriale)

*\*Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

(Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zerave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr persiper të realizojë).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit Nr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, "për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" (shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të liçencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë liçencë).

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategori a e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikasi mit i kërkuar për kategori në respektiv e	Vlera e punimeve (pa tvsh) që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP 2	Ndërtime civile dhe industriale	Punime suvatimi hidroizolimi murature	A	

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një **Deklarate (nga Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë te perfshirë në licensën e shoqërisë. Drejtuesi teknik duhet te jete :

#### **Inxhinier Ndertimi**

**“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :**

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë

Eshte kerkuar qe drejtuesi teknik të jetë inxhinier ndërtimi duke marë parasysh dhe natyrën e objektit të prokurimit per ndertim objekti

#### **2.3.4** Shoqeria duhet të paraqesë Çertifikata ISO

1. ISO 9001- 2015 (Sistemi i menaxhimit te cilesise).
2. ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit te mjedisit).
3. ISO 45001-2018 (Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)
4. PASS 99:2012 (Sistem i integruar i menaxhimit).

*Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH ose standardeve shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikata ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

*Për kriteret e përcaktuara në Kapacitetin teknik, Njësia e prokurimit ka zbatuar VKM Nr.285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 44 "Kërkesat e cilësisë" , si dhe bazuar në Rekomandimin e Agjensisë së Prokurimit Publik nr.8197 prot. datë 03.09.2018 ,për "Hartimin e Kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra,punë,shërbime. Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të jetë i certifikuar me çertifikatat Iso .*

**2.3.5** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 17 punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- **Murator** (4)
- **Hidraulike** (1)
- **pllakashtrues** (2)
- **Karpentier** (2)
- **Elektricist** (2)
- **Suvaxhi** (4)
- **Bojaxhi** (1)

**“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :**

1. kontrata e punës e vlefshme;
2. Çertifikate për sigurinë teknike të punonjësve (e vlefshme);  
ose  
Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik

- **Manovrator (1)**

*“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :*

**Kur mjetet janë në pronesi**

1. kontrata e punës (e vlefshme)
2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor

**Kur mjetet janë me qera**

*Deklarate nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqesë kontratë pune me manovratorin (i cili duhet të ketë Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor) deri në perfundimin e afateve të kontratës.*

- **Murator (4)**

*Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit Punime mur guri, mur me tulla, shtresa betony kerkohet që operatorin ekonomik të disponojë 4 muratore të cilët do të realizojnë këto punime.*

- **Manovrator (1)**

*Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit Germim dheu për themele është kërkuar që operatorin ekonomik të disponojë 1 mjet eskavator. Për drejtimin e tij është kërkuar 1 manovrator.*

- **Hidraulike (1)**

*Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit Punime hidrosanitare kerkohet që operatorin ekonomik të disponojë 1 hidraulik që do të realizojë këto punime.*

- **Pllakashtrues (2)**

*Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit Vendosje shtrese me pllaka kerkohet që operatorin ekonomik të disponojë 2 pllakashtrues që do të realizojnë këto punime.*

- **Karpentier (2)**

*Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit Punime izolimi dhe catie kerkohet që operatorin ekonomik të disponojë 2 karpentier që do të realizojnë këto punime.*

- **Elektricitist (2)**

*Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit Punime elektrike kerkohet që operatorin ekonomik të disponojë 2 elektricitiste që do të realizojnë këto punime.*

- **Suvaxhi (4)**

*Bazuar në zerat e punimeve për punime suvatimi kerkohet që operatorin ekonomik të disponojë 4 suvaxhi për realizimin e tyre*

- **Bojaxhi (1)**

*Bazuar në zerat e punimeve për punime bojatisje është kërkuar që operatorin ekonomik të disponojë 1 bojaxhi.*

**Argumentimi:**Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Përprokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

**2.3.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 20 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Kriteret e percaktuara ne piken 2.3.6. Eshtë kerkuar që operatori ekonomik të ketë një staf punonjësit për të realizuar punimet ,nga zberthimi i preventivit të punimeve me manualin e miratuar me Vendimin Nr.629, datë 15.07.2015 ”Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre ” .*

#### **OBJEKTI: NDËRTIM OBJEKTE NDERTIMORE**

<b>Nr.</b>	<b>Nr. AN</b>	<b>EMËRTIMI I PUNIMEVE</b>	<b>NJËSI</b>	<b>SASI</b>	<b>op/njesi</b>	<b>po/gji</b>
		<b>I PUNIME GERMIMI</b>				
1	2.5	Gërmim dheu për themele	m3	14.0	4.15	58.1
2	2.37/1a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 1 km	m3	14.0	1.0	14.0
		<b>II. PUNIME MURATURE TULLE</b>				0
1	2.86	Mur me tullë me 6 vrima t=10 cm, h~3m, llaç të përzier M 15	m³	4.0	14.0	56.0
2	2.64/1	Mur me tulla te plota ne lartesi deri 3m, llaç të përzier M 15	m³	42.0	11.0	462
3	2.52/2	Mur guri per themel e xokol me llaç çimento M 25	m³	32.0	7.6	243.2
		<b>III. PUNIME H/IZOLIMI DHE ÇATIE</b>				0
4	2.292	Trare tavani te sharuar	m2	100.0	0.4	37.0
1	2.219	Çati vendi e zakonshme Hd~8m, mbuluar me tjegulla betoni	m²	110.0	2.3	253
2	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine te lyer seksion katror	ml	16.0	1.1	17.4
3	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine te lyer e panderprere	ml	40.0	1.3	52
4	2.203	Veshje kornize me llamarine	m²	6.0	1.6	9.6
						0
		<b>IV PUNIME SHITESASH</b>				0.0



1	2,262/1	Shtrese betoni C7/10	m3	8.0	8.6	68.8
2	2.267/b	Shtresë me pllaka gres importi 40x40 cm	m <sup>2</sup>	88.0	1.5	135.5
3	2.324/b	Plintuse gres importi h=10 cm	ml	90.0	0.4	31.5
4	2.326	Veshje me pllaka majolike	m <sup>2</sup>	32.0	3.7	118.4
5	2.273/1	Shtrese me pllaka graniti t=2cm "ROSA BETA" (bazamake shk. jashtme)	m <sup>2</sup>	14.0	3.1	43.68
6	2.273	Shtrese pllake mermeri t=20mm (pragje dritaresh)	m <sup>2</sup>	3.0	3.1	9.4
7	2.258	Nenshtrese zhavori	m3	8.0	2.9	23.2
8	3,AN 8	Mbushje cakell	m3	56.0	2.9	162.4
		<b>V PUNIME SUVATIMI</b>				0
1	2.295	Tavan rrjete+suva	m2	85.0	4.7	399.5
2	2.312	Suva brenda h~4m me krah llaç të përzier M 25	m <sup>2</sup>	247.0	1.8	432.25
3	2.350	Suva xokoli me granit e cemento te zakonshme	m2	25.0	1	35.0
		<b>VI PUNIME DYER DHE DRITARE</b>				0
1	2.388/1	F.V Dyer te brendshme tamburato te rimesuara	m2	8.0	2.0	16.0
2	2,575/1	F.V.Dritare duroplast	m <sup>2</sup>	9.5	2.7	25.175
3	3.395	FV dyer duralumini dopio xham	m <sup>2</sup>	3.5	2.7	9.5
4	2.386/2	Dyer te blinduara importi	m <sup>2</sup>	3.8	3.0	11.4
		<b>VII PUNIME BOJATISJE</b>				0.0
1	2.404	Bojë hidroplastike importi	m <sup>2</sup>	335.0	0.36	120.6
		<b>VIII PUNIME BETONI DHE BETON ARME</b>				0.0
1	2.119/1	Brez, e arkitrarë b/a C16/20	m <sup>3</sup>	8	25.76	206.08
4	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø6-10mm	ton	0.8	60.0	48.0
		<b>PUNIME ELEKTRIKE</b>				0
1	2.490/e	F.V. Kuader elektrik brenda murit 12m	copë	1	3.1	3.1
2	2.487	F.V.Kuti shperndarese me kapak me vida PT-2	copë	10	0.33	3.3
3	2.485/1	F.V. Çeles ndriçimi 1P 10A 250V	copë	7	1.00	7.0
4	2.485/g	F.V. Priza shuko universale 2P+T 16A 250V	copë	16	1.0	16
6	An	Llampa Ekonomike	copë	12	1.5	18.0
7	2.490/1	F.V.Çeles diferencial 4P 40A 30 mA 500 V	copë	1	1.5	1.5
8	2.490/2	F.V.Çeles diferencial 1P 20A 30 mA 250 V	copë	3		4.5

					1.5	
9	2.490/2	F.V.Çeles automat 1P 16 A 250 V	copë	3	0.04	0.12
10	2.481/1	F.V. Percjelles bakri PVC 1.5mm	ml	250	0.04	10.0
11	2.481/2	F.V. Percjelles bakri PVC 2.5mm	ml	250	0.04	10
12	2.481/3	F.V. Percjelles bakri PVC 4mm	ml	150	0.04	6.0
13	480/2	F,V. Tubo freksibel i bute Ø 20 mm	ml	300	0.3	99
14	2.a-73	F.V. Elektroda tokezimi	copë	2	0.3	0.6
15	2.a-98	F.V. Shirit FeZn 20X3mm	ml	10	0.1	0.5
		<b>PUNIME HIDROSANITARE</b>				0.0
1	2.5	Gërmim e mbushje dheu me krah (kanal uji dhe kanalizim)	m <sup>3</sup>	2	4.15	8.3
2	2.26/a	Germim me eskavatoa	m <sup>3</sup>	6		0.0
3	2.37/1a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 1 km	m <sup>2</sup>	6		0
4	2.491/1b	F.V. tuba e rakorderi ujësjellësi, PE d=25mm, t=3.0mm, PN 20	ml	50	0.25	12.5
5	2.495	F.V. lavamanë porcelani importi me mishelator	copë	5	2.95	14.75
6	2.501	F.V. ËC allafrenga me kasetë	copë	2	3.7	7.4
7	2.519	F.V. tubo PVC kanalizimi d=90mm	ml	20	1.43	28.6
8	2.523	F.V. tubo PVC kanalizimi d=200mm	ml	50	1.9	95.0
9	An	Lidhje sahati +kasete	copë	1	2.0	2
10	An-18	Pusete shkarkimi b/a 50x50x100 cm	copë	1	4.5	4.5
11	2.491/1c	F.V.tubo rakorderi ujesjellesi,PE d=40mm, t=63,6mmPN20	ml	50	0.3	12.5
12	2.515	F.V Pilete dyshemeje Ø 50 mm	copë	2	1.7	3.4
13	3.326	Mur gurri per grope septike	m <sup>3</sup>	4	5.8	23.2
14	2.166	F.V. hekur betoni perjodik Ø6-10mm	ton	0.06	60.0	3.6
15	2.200	Soleta te plota gropa septike b/Ac16/20	m <sup>3</sup>	0.8	0.65	0.52
		<b>SISTEMIM I JASHEM</b>				0.0
1	2,258/2	Nenshtrese zhavori	m <sup>3</sup>	4.0	2.9	11.6
2	2,262/4	Shtrese betoni C16/20(rreth objektit)	m <sup>3</sup>	4.0	8.6	34.4
3	2,262/4	Shtrese betoni C 16/20 (rampe per invalidet)	m <sup>3</sup>	2.0	8.6	17.2
						<b>3,557.7</b>

- Nga zberthimi i preventivit oret e punes per cdo ze punimi rezultojne 3558

- Oret në total i pjestojmë me 8 orë pune ditore  $3558 : 8 = 445$   
kemi 445 punëtorë për një ditë pune
- 445 punëtorë për një ditë punë pjestuar më 22 ditë pune mujore kemi 20 punëtorë për një muaj punë.

**2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira mjetet e domosdoshme për realizimin e kontratës si më poshtë :**

Mjetet	Sasia	Gjendja
1. Eskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
2. Motobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
3. Kamioncine deri 3.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
4. Vinc kulle	1 copë	Pronësi ose me qera

**“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :**

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Police sigurimi (e vlefshme)
4. Mjeti të shoqerohet me fotografi të dukshme
5. Certifikate për leje transporti të leshuar nga Bashkia

dhe për mjetet me qera,

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
4. Police sigurimi (e vlefshme)
5. Mjeti të shoqerohet me fotografi të dukshme.]
6. Certifikate për leje transporti të leshuar nga Bashkia

Ne rastin e mjeteve me qera sipas njoftimit të APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit ,mjetet nuk duhet të rezultojnë vetëm për përdorim vetjak por edhe për përdorim nga të tretet.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre duke paraqitur aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

**1- Eskavator (1)**

Eshte kerkuar 1 eskavator per zerat e punimeve Germim dheu për themele.

**2- MotoBetoniere 2 copë**

Bazuar në zërin e preventivit për punime betoni eshte kerkuar 1 betoniere.

3- **Kamioncinë 1 cope**

*Eshte kërkuar 1 kamioncine për transportin e materialeve të ndryshme dhe të punonjësve*

4- **Vinç kullë 1 cope**

*Eshte kerkuar 1 vinc kulle per punime izolimi dhe catie,për ngritjen e tjegullave.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.